Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.
5. **Ofertat Alternative** Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.
6. **Çmimet**
 1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.
 2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.
 3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të

Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

7. Monedhat

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

8. Proveshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:
 - a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor
 - b) Garanci bankare
 - c) Garanci sigurimi

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga

Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

11. Paraqitja e Ofertave

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e Shërbimeve; Njoftimi Nr. ___.

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----” .

12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

13. Ofertat me vonesë

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

14. Tërheqja,

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e

Zëvendësimi dhe Modifikimet tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

15. Hapja e Ofertave

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

16. Konfidencialiteti

Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruaj konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

17. Sqarimi i ofertave

1. Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik

1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet

se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

20. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.
3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

22. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

– loti 1: “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë”

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Mbetjet e rrezikshme duhet të asgjeshen në një impiant për incenerim i cili është i liçencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të mëposhtme në lidhje me to:

Kërkesat e mëposhtme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, “Per lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, dt.18 shkurt 2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”.

- Mbetje me Kodin: **18 01 01, 18 01 03, 18 01 04** do të asgjeshen sipas VKM-së **Nr.798, date 29.09.2010** “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, shtojca 3, Metodot për trajtim dhe asgjësim pika 2) Me autoklavim, shtojca 5, Standartet teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore, Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin Kombëtar “Për Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore”.

- Mbetjet me kodin **18 01 02, 18 01 08** do të asgjeshen sipas VKM-së **Nr.798, date 29.09.2010** “Për administrimin e mbetjeve” Shtojca 3, Metodot për trajtim dhe asgjësim, pika 1, Incenerim “ shtojca 5, Standartet teknike për incenerim dhe autoklavim e mbetjeve Spitalore. Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin kombëtar “Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në udhëzuesin kombëtar “Administrimi i Sigurtë i

Mbetjeve Spitalore” .

2.Asgjësimi duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara ne VKM nr. 798 date 29.09.2010 “*Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”*”;

3.Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambientit të shërbimit që do të vendoset nga QSRT “Shefqet Ndroqi” Njësia Tiranë, me automjetet e tij të posaçëm/qira, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shënjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr. 4 të VKM– së Nr. 798 dt. 29.09.2010 *Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”*; dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin kombëtar “*Administrimi i sigurtë i mbetjeve të rrezikshme spitalore*“. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK –se.
Njoftimi bëhet me sms 2 (dy) ditë para.

4.Operatori duhet të ketë në pronësi /qira, minimalisht **2 (dy) mjete** dhe për këtë të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë osë të marrjes me qira të mjeteve.

5.Të përdorë kontenierë një përdorimsh plastike me qese plastmasi (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore.

6. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të AK – se, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutitë e ambalazhimit (pesha e tyre zbritet). Ambalazhimi (kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.

7. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik (OE të sjellë dhe çertifikatën e kolaudimit të peshores).

8. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara.

9. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga përfaqësuesi i AK –se tek OE fitues shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.

10. Operatori Ekonomik duhet të disponoje Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) së bashku me akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) që te përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03;18 01 04, ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim, ose teknologji ekuivalente.

11. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore*),që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 08 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

12. O E. duhet te kete Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 (sistemi menaxhimit te Cilesise)

13. OE duhet te kete Çertifikate SSH/EN ISO 14001 : 2015 (sistemi menaxhimit te Mjedisit)

14. Çertifikate ISO 45001:2018 (per sistemin e menaxhimit te sigurise ne pune).

Në Zbatim të të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018, të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe te lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë, të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë.

15. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjano – Sanitar subjektit ku kryen aktivitetin të lëshuar nga ISHSH (inspektoriati shëndetësor shtetëror).

16. Kërkoheq që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 10 (dhjetë) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët dy nga punonjësit duhet të jenë minimumi: një inxhinier mjedisi dhe një inxhinier kimik, 2 (dy) shofera për dy makina, 1 (një) administrator dhe 5 (pesë) punonjës mbështetës për ngarkimin/shkarkimin dhe përpunimin e mbetjeve), me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi 10 - dhjetë punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe

- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

▪ Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

• Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisit

• Minimumi 1 (një) Inxhinier Kimik

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

• CV përkatëse;

• Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;

• Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinjerin e mjedisit dhe inxhinjerin kimik.

17. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të autorizuar/licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme **gjatë kohëzgjatjes së Kontratave të lidhura me AK.**

18. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim të seciles kategori të prokuruar nga A.K të mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se Nr. 798, datë 29.09.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja), të licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qira të pajisjes (ku afati i marrjes me qira të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

b. Lejen mjedisore të impiantit të lëshuar nga Ministria Mjedisit, ku parashikohet trajtimi i mbetjeve objekt prokurimi.

19. Operatori ekonomik duhet të instalojë një frigoriferi në ambientet e Qendrës Spitalore Njësia Tiranë” me kapacitet 300 - 350 L dhe temperaturë - 18 C për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngshme dhe të ngurta deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit. Pas marrjes së mbetjeve operatori do të bëjë dezenfektimin e frigoriferit dhe ambientit përreth, si dhe mirembajtjen e frigoriferit.

20. Tek formulari i transferimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore të shënohen dhe kodet përkatëse për çdo lloj mbetje.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- loti 2: "Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë".

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Mbetjet e rrezikshme duhet të asgjesohen në një impiant për incenerim i cili është i liçencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të mëposhtme në lidhje me to:

Kërkesat e mëposhtme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme", ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 "Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, dt.18 shkurt 2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.05.2009, "Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar, Udhëzimin Kombëtar "Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore" dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore".

- Mbetje me Kodin: **18 01 01, 18 01 03, 18 01 04** do të asgjesohen sipas VKM-së **Nr.798, date 29.09.2010** "Për administrimin e mbetjeve spitalore", shtojca 3, Metodot për trajtim dhe asgjesim pika 2) Me autoklavim, shtojca 5, Standartet teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore, Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin Kombëtar "Për Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore".

- Mbetjet me kodin **18 01 02, 18 01 08** do të asgjesohen sipas VKM-së **Nr.798, date 29.09.2010** "Për administrimin e mbetjeve" Shtojca 3, Metodot për trajtim dhe asgjesim, pika 1, Incenerim " shtojca 5, Standartet teknike për incenerim dhe autoklavim e mbetjeve Spitalore. Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin kombëtar "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore" dhe sipas përcaktimeve të bëra në udhëzuesin kombëtar "Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore".

2. Asgjësimi duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”;

3. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga QSRT “Shefqet Ndroqi” Njësia Kavajë, me automjetet e tij të posaçëm/qira, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shënjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr. 4 të VKM – së Nr. 798 dt. 29.09.2010 Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”; dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin kombëtar “Administrimi i sigurtë i mbetjeve të rrezikshme spitalore“. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK – se. **Njoftimi bëhet me sms 2 (dy) ditë para.**

4. Operatori duhet të ketë në pronësi /qira, minimalisht **1 (një) mjet** dhe për këtë të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë osë të marrjes me qira të mjetit.

5. Të përdorë kontenerë një përdorimsh plastike me qese plastmasi (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore.

6. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të AK – se, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutitë e ambalazhimit (peshë e tyre zbritet). Ambalazhimi (kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.

7. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik (OE të sjellë dhe çertifikatën e kolaudimit të peshores).

8. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambjentit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara.

9. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga përfaqësuesi i AK –se tek OE fitues shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.

10. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) që të përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim, ose teknologji ekuivalente.

11. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore*), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 08 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

12. O E. duhet të ketë Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 (sistemi menaxhimit të Cilësisë)

13. OE duhet të ketë Çertifikatë SSH/EN ISO 14001 : 2015 (sistemi menaxhimit të Mjedisit)

